



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 27.01.2016, në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi dhe Senad Karaahmetovic, përfaqësuese e RTK- sërbisht-Marija Stanojevic, përfaqësuese e BIRN – Amire Qamili, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Stafi mbështetës i Komisionit, Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura, më 25.11/ 7.12. / 2-8.12. dhe 14.12 2015;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit, për vitin 2015;**
- 4. Diskutimi lidhur me hartimin e Planit të punës së Komisionit, për vitin 2016;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura më më 25.11/ 7.12. / 2-8.12. dhe 14.12 2015;**

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 25.11/ 7.12. / 2-8.12. dhe 14.12 2015, pa vërejte.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit, për vitin 2015;

Kryesuesja, tha se para vetës kemi raportin vjetor të punës së komisionit për vitin 2015. Në kaudër të monitorimit të Ligjieve, gjatë vitit paraprak Komisioni ka realizuar punën e monitorimit të Ligjit për Hoçën e madhe dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, dhe ka mbetur që Raporti të procedohet në Kryesi dhe më pas miraohen në Kuvend.

Mendon se për këtë vitë kan mbetur të vazhdohet me monitorimin e ligjeve tjera dhe detyrat e parealizuara do të barten për vitin 2016.

Në këtë mbledhje, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxorri këtë:

Përfundim

Komisioni, njëzëri miratoi Raportin e punës, për vitin 2015.

4. Hartimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2016;

Kryesuesi, tha se në bazë të Rregullorës së Kuvendit dhe programit Legjislativë të Qeverisë ngarkohet Komisioni të hartoj planin e punës, për vitin 2016. Si prioritet në këtë vit do të monitorohet ligji për Shërbyes Civil, konkretisht neni 11, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale.

Në bazë të programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si Komision funksional, në muajin gusht 2016, do të procedohet për shqyrtim Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 03/L-047 për mbrojtjen dhe oromovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

I njoftoi anëtarët e komisionit se lidhur me hartimin e Planit të punës së Komisionit, për vitin 2016, do të organizohet një puntori e pune, e mbështetur nga misioni i OSBE-së. Për detaje e mbajtjes së puntorisë, fjalën ia dha përfaqësueses së OSBE-s.

Adriana Gashi, ideja e mbështetjes së puntërisë është hartimi dhe finalizimi i planit të punës me aktivitetet e komisionit, agjenda legjislative për vitin 2016, si dhe planifikimi i monitorimit buxhetor të një ligji., Për hartimin e Draft - Planit të Punës së Komisionit, organizata e OSBE-së ka parapar vetëm një ditë pune e cila parashihet të mbahet në javën e parë të muajit shkurt 2016. Këtë organizata jonë planifikon të realizojë vizitë studimore në Kroaci, për 8 anëtar të komisionit.

Veton Berisha, sa i përket Planit të punës të vitit 2015, kanë mbetur të parealizura shumë çështje, siq janë vizitat në komunat ku ka probleme komuniteti jonë. Njëherit, si propozim dha që komisioni në periudhë sa më të afërt të planifikojë vizitë zyrtare me ministrin e MASHT-it, lidhur me mos regjistrimin e sutdentëve të komunitetit joshumicë, për vitin akademik 2015/2016.

Danush Ademi, shprehu shqetësimin e tij me rastin e humbjes jetë të fëmiut të komuniteti të tij në Komunën e Gjakovës, me këtë rast shprehë ngushllime për këtë familje. Gjithashtu, kërkoi që Komisioni të vizitoi komunën e Gjakovës, me arsye të kërkohet mbështetje e plotë edhe për familjet e komunitetit tonë.

Njëherit, nuk e sheh të arsyeshme që Komisioni të takohet me ministrin z. Arsim Bajrami, nga se kanë kaluar të gjitha afatet kohore për regjistrim të studentëve të komunitetit jo shumicë. Është mirë që kjo çështje të ngritet me kohë dhe të jetë aktuale, për vitin akademik 2016/2017.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e komisionit u pajtuan që përilimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016, të shtyhet për takimin e radhës

Në bazë të diskutimeve, anëtarët e Komisionit, nxorrën këtë:

Përfundim

Me arsye të respektimit të afateve kohore, në hartimin e Planit të Punës për vitin 2016, komisioni paraprakisht do të mbaj mbledhje me datën 29.01.2016, ku do dalë me propozime konkrete me shkrim.

Gjegjësisht, për finalizimin e Raportit të Punës për vitin 2016, do të organizohet puntori pune, me datën 5 janar 2016, në ora 10, në Hotel 'Sirius.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Jasmina Zhivkoviq